



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 56**

**18 prill**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM  
nr. 243, datë 3.4.2013

Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF13972, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga disa donatorë, për financimin e projektit “Ngritje e kapaciteteve dhe mbështetje për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar (SPI)”.....

2419

Vendim i KM  
nr. 264, datë 3.4.2013

Për organizimin e punës për përafrimin e legjislacionit në fushën e së drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve.....

2439

**VENDIM**  
**Nr. 243, datë 3.4.2013**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF13972, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA DISA DONATORË, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “NGRITJE E KAPACITETEVE DHE MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR (SPI)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF13972, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga disa donatorë, për financimin e projektit “Ngritje e kapaciteteve dhe mbështetje për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar (SPI)”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



18 shkurt 2013

Për Z. Ridvan Bode  
Ministër i Financave  
Ministria e Financave  
Blvd. Dëshmorët e Kombit  
Nr. 1  
Tiranë, Shqipëri

Lënda: Shqipëria: Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të  
Integruar (SPI)  
Grant nr. TF013972

**Udhëzime shtesë: Letra e lëvrimit**

I nderuar shkëlqesi,

Ju drejtohem në lidhje me Letër-Marrëveshjen ("Marrëveshja") ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim ("Banka Botërore"), me cilësinë e administratorit të fondeve në formë granti të dhëna nga disa donatorë ("Donatorët" janë Suedia, Zvicra dhe Austria) në kuadër të Fondit të Dytë Shumëpalësh të Besimit të Donatorëve për SPI-në e Shqipërisë (SPI 2), dhe Shqipërisë ("Marrësi") për projektin e lartpërmendur, datë 18 shkurt 2013. Marrëveshja parashikon që Banka Botërore mund të japë udhëzime të tjera shtesë lidhur me tërheqjen e fondeve të Grantit Nr. TF013972 ("Granti"). Udhëzimet shtesë përbëhen nga kjo letër ("Letra e lëvrimit"), me rishikimet që mund t'i bëhen herë pas here.

Udhëzimi i Bankës Botërore për Lëvrimin e Fondeve për Projektet, datë 1 maj 2006, ("Udhëzimi për lëvrimin") bashkëlidhur kësaj Letre të lëvrimit (Lidhja 1) është pjesë integrale e Letrës së lëvrimit. Mënyra me të cilën zbatohen për Grantin dispozitat e Udhëzimit për lëvrimin përcaktohet më poshtë. Seksionet dhe nënseksionet në kllapa, më poshtë, u referohen seksioneve dhe nënseksioneve në Udhëzimin për lëvrimin dhe, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë letër, termat që fillojnë me shkronjë të madhe kanë kuptimin e përcaktuar në Udhëzimin për Lëvrimin.

**I. Rregullimet për lëvrimin**

**(i) Mënyrat e Lëvrimit (seksioni 2).** Mund të përdoren Mënyrat e mëposhtme të Lëvrimit për Grantin:

- Rimbursimi
- Paradhënia
- Pagesa e drejtpërdrejtë

**(ii) Data e Afatit të Lëvrimit (nënseksioni 3.7).** Data e Afatit të Lëvrimit është 4 muaj pas Datës së Mbylljes të përcaktuar në Marrëveshjen e Grantit. Çdo ndryshim i kësaj date i njoftohet Bankës Botërore.

**(iii) Kushtet e Lëvrimit (nënseksioni 3.8).** Ju lutem shihni Kushtet për Tërheqjen në Marrëveshjen e Grantit.

## **II. Tërheqja e fondeve të Grantit**

**(i) Nënshkrimet e Autorizuara (nënseksioni 3.1).** Bankës Botërore i duhet dorëzuar në adresën si më poshtë një letër sipas Formës bashkëlidhur (Lidhja 2), ku të jepen emri ose emrat dhe nënshkrimi ose nënshkrimet model të zyrtarit ose zyrtarëve të autorizuar për të dorëzuar Kërkesat:

The World Bank  
1818 H Street, N.W.  
Washington, DC 20433  
United States of America  
Në vëmendje të: Drejtorit të Vendit

**(ii) Kërkesat (nënseksionet 3.2).** Ju lutem, vini në dispozicion kërkesat e plotësuar për tërheqjen, së bashku me dokumentet mbështetëse, përmes portalit në internet “Client Connection” të Bankës Botërore, duke ndjekur udhëzimet për dorëzimin elektronik. Nëse marrësi nuk ka lidhje me internetin, Banka Botërore mund të lejojë dorëzimin e kërkesave për tërheqje, së bashku me dokumentet mbështetëse, në përputhje me nënseksionin 3.3, në adresën e mëposhtme:

The World Bank  
Radnicka cesta 80/IX  
10000 Zagreb, Croatia  
Në vëmendje të: Departamentit të Huasë

**(iii) Dorëzimi Elektronik (nënseksioni 3.4)** Mundësia për t’ia dërguar Kërkesën Bankës Botërore në mënyrë elektronike mund të shfrytëzohet nëse: (a) Marrësi ka përcaktuar me shkrim, në përputhje me kushtet e pikës “i” të këtij seksioni, zyrtarët e tij të cilët janë të autorizuar të nënshkruajnë dhe dorëzojnë Kërkesat dhe të marrin pajisjet e identifikimit të sigurt (“Pajisjet e Identifikimit”) nga Banka Botërore me qëllim dorëzimin e këtyre Kërkesave në mënyrë elektronike; dhe (b) të gjithë zyrtarët e përcaktuar nga Marrësi janë regjistruar si përdorues të portalit “Client Connection”. Nëse Banka Botërore bie dakord, ajo i vendos në dispozicion Marrësit Pajisjet e Identifikimit për zyrtarët e përcaktuar. Pas kësaj, zyrtarët e caktuar mund t’i dorëzojnë Kërkesat në mënyrë elektronike duke plotësuar Formularin 2380, i cili mund të arrihet përmes portalit “Client Connection” (<https://clientconnection.worldbank.org>). Marrësi mund të vijojë ta ushtrojë mundësinë e përgatitjes dhe dorëzimit të Kërkesave në mënyrë shkresore. Banka Botërore ruan të drejtën dhe, nëse vendos vetë, mund ta heqë përkohësisht ose përgjithmonë mundësinë e dorëzimit elektronik të Kërkesave nga Marrësi.

**(iv) Termat dhe Kushtet e Përdorimit të Pajisjeve të Identifikimit për Përpunimin e Kërkesave.** Duke përcaktuar zyrtarët për pranimin e Pajisjeve të Identifikimit dhe duke vendosur t’i dorëzojë në mënyrë elektronike Kërkesat, Marrësi konfirmon përmes letrës për nënshkruesit e autorizuar se bie dakord që: (a) të respektojë Kushtet e Përdorimit të Pajisjeve të Identifikimit të Sigurt në lidhje me Përdorimin e Mjeteve Elektronike për Përpunimin e Kërkesave dhe Dokumentacionit Mbështetës (“Kushtet e Përdorimit të



Pajisjeve të Identifikimit”) të parashikuara në Lidhjen 3: dhe (b) t’ia japë Kushtet e Përdorimit të Pajisjeve të Identifikimit secilit prej këtyre zyrtarëve dhe të kujdeset që çdo zyrtar i tillë t’i respektojë kushtet në fjalë.

**(v) Vlera Minimale e Kërkesave (nënseksioni 3.5).** Vlera Minimale e Kërkesave për Rimbursim dhe Pagesë të Drejtpërdrejtë është e barasvlershme me 100.000 dollarë amerikanë.

**(vi) Paradhëniet (seksionet 5 dhe 6) për Njësinë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit.**

- **Lloji i Llogarisë së Përcaktuar (nënseksioni 5.3):** Më vete (e veçuar)
- **Monedha e Llogarisë së Përcaktuar (nënseksioni 5.4):** Euro
- **Institucioni Financiar pranë të cilit do të çelet Llogaria e Përcaktuar (nënseksioni 5.5):**  
Banka e Shqipërisë
- **Tavani (nënseksioni 6.1)** 300.000 euro

### III. Raportimi për Përdorimin e Fondeve të Grantit

**(i) Dokumentacioni Mbështetës (seksioni 4).** Për çdo kërkesë për tërheqje duhet të vihet në dispozicion dokumentacioni mbështetës siç përcaktohet më poshtë:

- **Për kërkesat për Rimbursim:**
  - Pasqyra e Shpenzimeve sipas formës bashkëlidhur (Lidhja 4);
  - Lista e pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga Banka Botërore, sipas formës bashkëlidhur (Lidhja 5).
- **Për raportimin e shpenzimeve të lejuara që paguhen nga Llogaria e Përcaktuar:**
  - Pasqyra e Shpenzimeve sipas formës bashkëlidhur (Lidhja 4);
  - Lista e pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga Banka Botërore, sipas formës bashkëlidhur (Lidhja 5); dhe
  - Një rakordim i Llogarisë së Përcaktuar, sipas formës bashkëlidhur (Lidhja 6), me një kopje të ekstraktit bankar.
- **Për kërkesat për Pagesë të Drejtpërdrejtë:** evidenca që dëshmojnë shpenzimet e lejuara, për shembull kopje të mandat-pagesave, fatura të furnitorëve

**(ii) Shpeshtësia e raportimin të shpenzimeve të lejuara që paguhen nga Llogaria e Përcaktuar (nënseksioni 6.3):** Çdo tremujor ose më shpesh nëse kërkohet.

#### **IV. Informacione të tjera të rëndësishme**

Për informacione të mëtejshme për rregullimet për lëvrimin, ju lutemi shihni Manualin për Lëvrimin i cili gjendet në faqen publike në internet të Bankës Botërore <https://www.worldbank.org> dhe në faqen e saj të sigurt në internet “Client Connection” me adresë <https://clientconnection.worldbank.org>. Sipas kërkesës, mund të vihen në dispozicion edhe kopje të shtypura.

Nëse nuk jeni regjistruar ende, Banka Botërore ju rekomandon të regjistroheni si përdorues i portalit “Client Connection” (<https://clientconnection.worldbank.org>). Nga kjo faqe interneti do të keni mundësi të shkarkoni Kërkesat, të ndiqni gjendjen e Grantit në kohë reale dhe të nxirrni informacionet e lidhura për politikën, financat dhe prokurimet. Të gjithë zyrtarëve të Marrësit të cilët janë autorizuar të nënshkruajnë dhe dorëzojnë Kërkesat në mënyrë elektronike u kërkohet të regjistrohen në “Client Connection” përpara kryerjen së dorëzimit elektronik. Për më shumë informacion për hapësirën në internet dhe rregullimet për regjistrimin, ju lutemi kontaktoni Bankën Botërore përmes postës elektronike në adresën [clientconnection@worldbank.org](mailto:clientconnection@worldbank.org).

Nëse keni pyetje në lidhje me sa më lart, ju lutemi kontaktoni LOA-TF duke dërguar një letër elektronike në adresën [loa-tf@worldbank.org](mailto:loa-tf@worldbank.org) dhe duke përdorur numrin e fondit të besimit në rreshtin e lëndës.

Me respekt,

Kseniya Lvovsky  
Drejtoresh e Zyrës në Shqipëri

#### **Lidhjet**

1. *Udhëzimi i Bankës Botërore për Lëvrimin e Fondeve për Projektet*, datë 1 maj 2006
2. Formulari për Nënshkrimet e Autorizuara
3. Kushtet e Përdorimit të Pajisjeve të Identifikimit të Sigurt në lidhje me Përdorimin e Mjeteve Elektronike për Përpunimin e Kërkesave dhe Dokumentacionit Mbështetës, datë 20 janar 2010
4. Forma e Pasqyrës së Shpenzimeve
5. Forma e Listës së pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga Banka Botërore
6. Pasqyra e Rakordimit të Llogarisë së Përcaktuar

Kopjet,  
dijeni: për [Subjekti zbatues i projektit]  
[adresa postare]  
[qyteti], [vendi]  
[adresa e email-it]



Lidhja [2]

[Koka]  
Ministria e Financave  
[adresa postare]  
[qyteti], [vendi]

[DATE]

Bankës Botërore  
1818 H Street, N.W.  
Uashington, D. K. 20433  
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Në vëmendje: Drejtorit për Vendin

I nderuar Drejtor për vendin:

**Lënda: Shqipëria: Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Sistemit të  
Planifikimit të Integruar (SPI) Grant nr. TF013972**

Ju drejtohem në lidhje me Marrëveshjen për Grantin ("Marrëveshja") ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim ("Banka Botërore"), me cilësinë e administratorit të fondeve në formë granti të dhëna nga disa donatorë ("Donatorët" janë Suedia, Zvicra dhe Austria) në kuadër të Fondit të Dytë Shumëpalësh të Besimit të Donatorëve për SPI-në e Shqipërisë (SPI 2), dhe Shqipërisë ("Marrësi"), datë \_\_\_\_\_, ku parashikohet Granti i lartpërmendur. Për qëllimet e seksionit 3.04 shkronja "b" të Kushteve Standarde, sikurse parashikohet në Marrëveshje, secili<sup>1</sup> prej personave nënshkrimi model i vërtetuar jepet më poshtë është i autorizuar të nënshkruajë në emër të Marrësit kërkesat për tërheqjen e fondeve në kuadër të këtij Granti.

Me qëllim dorëzimin e Kërkesave Bankës Botërore, secili<sup>2</sup> prej personave nënshkrimi model i vërtetuar jepet më poshtë është i autorizuar, në emër të marrësit, duke vepruar

<sup>1</sup> Udhëzim për Marrësin kur t'i dërgojë këtë letër Bankës Botërore: Përcaktoni nëse Kërkesat duhet t'i nënshkruajë më shumë se një person, dhe sa pozicione ose cilat pozicionet, dhe nëse zbatohet ndonjë prag kufi. Ju lutemi ta fshini këtë poshtëshënim në letrën përfundimtare që do t'i dërgoni Bankës Botërore.

<sup>2</sup> Udhëzim për Huamarrësin: Përcaktoni nëse Kërkesat duhet t'i nënshkruajnë bashkërisht më shumë se një person, nëse po ju lutemi përcaktoni numrin e personave. Ju lutemi ta fshini këtë poshtëshënim në letrën përfundimtare që do t'i dërgoni Bankës Botërore.

[veçmas<sup>3</sup>] [bashkërisht<sup>4</sup>], të dorëzojë Kërkesat dhe evidencat në mbështetje të tyre sipas kushteve të përcaktuara nga Banka Botërore.

<sup>5</sup>[Kjo konfirmon që Marrësi i autorizon këta persona të marrin Pajisjet e Identifikimit dhe të dorëzojnë Kërkesat dhe dokumentet mbështetëse Bankës Botërore në mënyrë elektronike. Duke pranuar plotësisht që Banka Botërore do të mbështetet në konfirmime dhe garanci të tilla, duke përfshirë pa kufizim, konfirmimet dhe garancitë që përmbajnë *Kushtet e Përdorimit të Pajisjeve të Identifikimit të Sigurt në lidhje me Përdorimin e Mjeteve Elektronike për Përpunimin e Kërkesave dhe Dokumentacionit Mbështetës* ("Kushtet e Përdorimit të Pajisjeve të Identifikimit"), marrësi i konfirmon dhe i garanton Bankës Botërore se do t'u japë secilit prej këtyre personave një kopje të Kushteve të Përdorimit të Pajisjeve të Identifikimit dhe do të kujdeset që çdo person i tillë t'i respektojë kushtet në fjalë.]

Ky Autorizim zëvendëson dhe shfuqizon çdo Autorizim që ndodhet tani në evidencat e Bankës Botërore në lidhje me këtë Marrëveshje.

[emri], [pozicioni] Nënshkrimi Model: \_\_\_\_\_

[emri], [pozicioni] Nënshkrimi Model: \_\_\_\_\_

[emri], [pozicioni] Nënshkrimi Model: \_\_\_\_\_

Me konsideratë

/ nënshkrimi /

\_\_\_\_\_  
[Pozicioni]

<sup>3</sup> Udhëzim për Huamarrësin: Përdorini këto kllapa nëse mund të nënshkruajë cilido prej personave të autorizuar; nëse nuk zbatohet kjo mundësi, ju lutemi hiqini kllapat. *Ju lutemi ta fshini këtë poshtëshënim në letrën përfundimtare që do t'i dërgoni Bankës Botërore.*

<sup>4</sup> Udhëzim për Huamarrësin: Përdorini këto kllapa vetëm nëse secilën Kërkesë duhet ta nënshkruajnë bashkërisht disa individë; nëse nuk zbatohet kjo mundësi, ju lutemi shuajini kllapat. *Ju lutemi fshini këtë poshtëshënim në letrën përfundimtare që do t'i dërgoni Bankës Botërore.*

<sup>5</sup> Udhëzim për Huamarrësin: Përfshijeni këtë paragraf nëse Marrësi dëshiron t'i autorizojë personat e renditur të marrin Pajisje Identifikimi dhe të dorëzojnë Kërkesa në mënyrë elektronike; nëse nuk zbatohet kjo mundësi, ju lutemi fshini këtë paragraf. *Ju lutemi fshini këtë poshtëshënim në letrën përfundimtare që do t'i dërgoni Bankës Botërore.*



**Kushtet e Përdorimit të Pajisjeve të Identifikimit të Sigurt  
në lidhje me Përdorimin e Mjeteve Elektronike  
për Përpunimin e Kërkesave  
dhe Dokumentacionit Mbështetës**

20 janar 2010

Banka Botërore (Banka)<sup>6</sup> do të vendosë në dispozicion pajisjet e identifikimit të sigurt (Pajisjet e Identifikimit) për t'i lejuar Huamarrësit<sup>7</sup> të dorëzojë Bankës kërkesat për tërheqjen e fondeve dhe kërkesat për angazhimet e posaçme në bazë të Marrëveshjes ose Marrëveshjeve dhe dokumentacionin mbështetës (këto kërkesa dhe dokumentacione mbështetëse quhen së bashku në këto Kushte të Përdorimit si Kërkesa) në mënyrë elektronike, sipas kushteve të përdorimit të përcaktuara në këtë dokument.

**A. Identifikimi i përdoruesve.**

1. Huamarrësit i kërkohet të identifikojë në një Letër për Nënshkruesit e Autorizuar (LNA) të dorëzuar rregullisht Bankës dhe të marrë rregullisht prej saj, secilin person që do të jetë i autorizuar të dorëzojë Kërkesa. Banka do t'i japë Pajisje Identifikimi secilit person të identifikuar në Letrën për Nënshkruesit e Autorizuar (Nënshkruesi), siç parashikohet më poshtë. Huamarrësi njofton menjëherë Bankën nëse një Nënshkrues nuk është më i autorizuar nga Huamarrësi për të vepruar si Nënshkrues.
2. Çdo Nënshkrues duhet të regjistrohet si përdorues në portalin në internet "Client Connection" (CC) të Bankës Botërore (<https://clientconnection.worldbank.org>) përpara marrjes së Pajisjeve të Identifikimit. Regjistrimi në CC do të kërkojë që Nënshkruesi të vendosë një fjalëkalim për CC-në (Fjalëkalimi i CC-së). Nënshkruesi nuk duhet t'ia tregojë askujt Fjalëkalimin e CC-së dhe as nuk duhet ta ruajë apo ta regjistrojë Fjalëkalimin e CC-së në formë të shkruar apo në një formë

<sup>6</sup> "Banka" përfshin Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim.

<sup>7</sup> "Huamarrësi" përfshin huamarrësin e një huaje nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, një kredie nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim ose një paradhënieje financuese për përgatitje projekti dhe marrësin e një granti.

tjetër. Pas regjistrimit si përdorues në CC, Nënshkruesit do t'i caktohet një emër llogarie identifikues unik.

#### **B. Shpërndarja, vënia në funksionim dhe kthimi i Pajisjeve të Identifikimit.**

1. Banka do t'i japë fizikisht një Pajisje Identifikimi secilit Nënshkrues sipas një mënyre që përcaktohet nga Banka dhe është e pranueshme për Bankën.
2. Në momentin e dhënies së një Pajisjeje Identifikimi një Nënshkruesi, Nënshkruesi merr një kopje të këtyre Kushteve të Përdorimit në funksion të vënies në funksionim të Pajisjes së Identifikimit.
3. Banka do të verifikojë nëse Pajisja e Identifikimit, Fjalëkalimi i Përkohshëm dhe Kushtet e Përdorimit i janë dhënë rregullisht dhe janë marrë rregullisht nga Përdoruesi i CC-së.
4. Menjëherë pas marrjes së Pajisjes së Identifikimit dhe të Kushteve të Përdorimit, Nënshkruesi do të hyjë në CC duke përdorur emrin e vet të llogarisë dhe fjalëkalimin e CC-së dhe do të regjistrojë Pajisjen e Identifikimit dhe do të vendosë një numër të identifikimit personal (numër PIN) që do të përdoret në lidhje me përdorimin e Pajisjes së tij të Identifikimit, pas së cilës Pajisja e Identifikimit do të vihet në funksionim për t'u përdorur në mënyrë ekskluzive nga Nënshkruesi në funksion të dorëzimit të Kërkesave. Pas vënies në funksionim të Pajisjes së Identifikimit, Nënshkruesi do të jetë "Përdorues me Pajisje Identifikimi". Banka do të mbajë në bazën e saj të të dhënave një llogari përdoruesi (Llogaria) për çdo Përdorues me Pajisje Identifikimi në funksion të administrimit të Pajisjes së Identifikimit ose të Përdoruesit me Pajisje Identifikimi. As Huamarrësi as Përdoruesi me Pajisje Identifikimi nuk do të kenë asnjë të drejtë hyrjeje në Llogari.
5. Përpara përdorimit për herë të parë të Pajisjes së Identifikimit nga Përdoruesi i Pajisjes së Identifikimit për dorëzimin e Kërkesave, Huamarrësi siguron që Përdoruesi i Pajisjes së Identifikimit të ketë marrë materialet e trajnimit të vendosura në dispozicion nga Banka për përdorimin e Pajisjes së Identifikimit.
6. Pajisjet e Identifikimit i kthehen menjëherë Bankës me kërkesën e kësaj të fundit.

#### **C. Administrimi i Pajisjeve të Identifikimit.**

1. Pajisjet e Identifikimit mbeten pronë e Bankës.
2. Përdorimi i Pajisjeve të Identifikimit bëhet rreptësisht vetëm për dorëzimin e Kërkesave nga Përdoruesi i Pajisjes së Identifikimit sipas mënyrës të përcaktuar nga Banka në Marrëveshje dhe në këto Kushte. Ndalohet çdo përdorim tjetër i Pajisjes së Identifikimit.
3. Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për çdo keqpërdorim të Pajisjes së Identifikimit nga Përdoruesi i Pajisjes së Identifikimit, nga përfaqësues të tjerë të Huamarrësit apo nga të tretë.
4. Huamarrësi merr përsipër të sigurojë, dhe i konfirmon dhe garanton Bankës (konfirmime dhe garanci mbi të cilën do të mbështetet shprehimisht Banka lidhur me dhënien e Pajisjes së Identifikimit çdo Përdoruesi me Pajisje Identifikimi) se çdo Përdoruesi me Pajisje Identifikimi do t'i jepen këto Kushte të Përdorimit, përfshirë sa më poshtë, dhe se çdo Përdorues Pajisjeje Identifikimi i kupton dhe i respekton këto kushte.



### ***Siguria***

- 4.1. Përdoruesi i Pajisjes së Identifikimit nuk duhet t'ia tregojë askujt numrin PIN të tij dhe as nuk duhet ta ruajë apo ta regjistrojë numrin PIN në formë të shkruar apo në një formë tjetër.
- 4.2. Përdoruesi i Pajisjes së Identifikimit nuk duhet t'ia lejojë askujt tjetër të përdorë Pajisjen e Identifikimit për t'i dorëzuar një Kërkesë Bankës.
- 4.3. Përdoruesi i Pajisjes së Identifikimit duhet të dalë gjithmonë nga llogaria e vet në CC kur nuk e përdor sistemin. Mosdalja si duhet nga llogaria personale mund të krijojë një rrugë hyrjeje të pambrojtur në sistem.
- 4.4. Nëse Përdoruesi i Pajisjes së Identifikimit beson se një i tretë ka mësuar numrin PIN të tij ose nëse ka humbur Pajisjen e vet të Identifikimit ai njofton menjëherë në adresën [clientconnection@worldbank.org](mailto:clientconnection@worldbank.org).
- 4.5. Huamarrësi njofton menjëherë Bankën në adresën [clientconnection@worldbank.org](mailto:clientconnection@worldbank.org) për çdo Pajisje Identifikimi të humbur, të vjedhur apo të komprometuar dhe merr hapa të tjerë të arsyeshëm për të siguruar që Pajisje Identifikimi të tilla të çaktivizohen menjëherë.

### ***Kujdesi për Pajisjet e Identifikimit***

- 4.6. Pajisjet e Identifikimit përmbajnë instrumente të brishta dhe të sofistikuara dhe, për rrjedhojë, duhen përdorur me kujdesin e duhur dhe nuk duhen futur në lëngje, nuk duhen ekspozuar në temperatura të skajshme, nuk duhen shtypur e as nuk duhen përkulur. Gjithashtu, Pajisjet e Identifikimit duhen mbajtur më shumë se 5 (pesë) centimetra larg pajisjeve që prodhojnë rrezatim elektromagnetik (RREM), siç janë telefonat celularë, PDA-të e lidhura me rrjetin telefonik, celularët inteligjentë dhe pajisje të tjera të ngjashme. Pajisjet e Identifikimit duhen mbajtur dhe ruajtur jo pranë pajisjeve me RREM. Në rreze të shkurtër (më pak se 5 centimetra) këto pajisje mund të lëshojnë nivele të larta RREM që mund të ndërhyjnë në funksionimin e duhur të pajisjeve elektronike, që përfshin edhe Pajisjen e Identifikimit.
- 4.7. Pa cenuar këto Kushte të Përdorimit, udhëzimet e tjera teknike për përdorimin dhe kujdesin e duhur për Pajisjet e Identifikimit gjenden në adresën <http://www.rsa.com>.

### ***5. Zëvendësimi***

- 5.1. Pajisjet e Identifikimit që janë humbur, dëmtuar, komprometuar (sipas parashikimeve në pikën 4.5, më lart) ose shkatërruar do të zëvendësohen me shpenzimet e Huamarrësit.
- 5.2. Banka ruan të drejtën, duke vendosur vetë, për të mos zëvendësuar asnjë Pajisje Identifikimi në rast keqpërdorimi apo për të mos riaktivizuar llogarinë e një Përdoruesi me Pajisje Identifikimi.

### ***6. Ruajtja e të drejtës për të çaktivizuar Pajisjen e Identifikimit***

- 6.1. Huamarrësi ruan të drejtën për të revokuar autorizimin e një Përdoruesi me Pajisje Identifikimi për të përdorur Pajisjen e Identifikimin për çfarëdo arsye.
- 6.2. Banka ruan të drejtën, duke vendosur vetë, për të çaktivizuar përkohësisht ose përgjithmonë një Pajisje Identifikimi, për të çaktivizuar llogarinë e një Përdoruesi me Pajisje Identifikimi, apo për të ndërmarrë të dy këto veprime.

## Pasqyra e Shpenzimeve

Pagesat e kryera gjatë periudhës nga \_\_\_\_\_ deri \_\_\_\_\_

**Datë:** \_\_\_\_\_  
**Kërkesa Nr.:** \_\_\_\_\_  
**FB Nr.:** \_\_\_\_\_  
**PSH Nr.:** \_\_\_\_\_

[illegible]

Dokumentet mbështetëse për këtë pasqyrë të shpenzimeve mbahen në: (përfshini vendndodhjen)



Pagesat e kryera gjatë periudhës së raportimit

kundrejt kontratave që i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga Banka Botërore

| Kontrata<br>Nr. | Furnitori | Data e<br>kontratës | Vlera e<br>Kontratës | Data e<br>moskundërshtimit<br>të Kontratës nga<br>BB-ja | Shuma që i<br>është paguar<br>furnitorit gjatë<br>periudhës | Pjesa e BB-së<br>në shumën që<br>i është paguar<br>furnitorit gjatë<br>periudhës |
|-----------------|-----------|---------------------|----------------------|---------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|
|                 |           |                     |                      |                                                         |                                                             |                                                                                  |

Lidhja [6]

**PASQYRA E RAKORDIMIT TË LLOGARISË SË PËRCAKTUAR**

FONDI I BESIMIT NR. \_\_\_\_\_  
LLOGARIA NR. \_\_\_\_\_ PRANË (BANKA) \_\_\_\_\_

1. PARADHËNIA GJITHSEJ NGA BANKA BOTËRORE (OSE NGA BASHKËFINANCUESI) \_\_\_\_\_ \$
2. MINUS: SHUMËN GJITHSEJ QË KA KOMPENSUAR BANKA BOTËRORE \_\_\_\_\_ \$
3. SHUMA AKTUALE QË MBETET PËR T'U SHLYER E KALUAR PARADHËNIE NË LLOGARINË E PËRCAKTUAR (SHUMA 1 MINUS SHUMËN 2) = \_\_\_\_\_ \$

=====

4. TEPRICA E LLOGARISË SË PËRCAKTUAR SIPAS EKSTRAKTIT TË LIDHUR BANKAR DERI MË DATËN \_\_\_\_\_ \$
5. PLUS: SHUMA GJITHSEJ E KËRKUAR ME KËTË KËRKESË NR. \_\_\_\_\_ + \_\_\_\_\_ \$\*
6. PLUS: SHUMA GJITHSEJ E TËRHEQUR DHE E PAKËRKUAR ENDE ARSYEJA: \_\_\_\_\_ + \_\_\_\_\_ \$\*
7. PLUS: SHUMAT E KËRKUARA ME KËRKESAT E MËPARSHME TË PAKREDITUARA ENDE MË DATËN E EKSTRAKTEVE BANKARE

| KËRKESA NR. | SHUMA * |
|-------------|---------|
| _____       | _____   |
| _____       | _____   |

NËNSHUMA E KËRKESAVE  
TË MËPARSHME TË PAKREDITUARA ENDE + \_\_\_\_\_ \$

8. MINUS: INTERESI I FITUAR - \_\_\_\_\_ \$\*
9. PARADHËNIA GJITHSEJ E REGJISTRUAR (PIKAT 4 DERI 9) = \_\_\_\_\_ \$
10. SHPJEGIMI I ÇDO DIFERENCA MIDIS SHUMAVE NË PIKAT 3 DHE 9:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

11. MË: \_\_\_\_\_ NËNSHKRIMI: \_\_\_\_\_  
TITULLI: \_\_\_\_\_

\* TË GJITHA PIKAT DUHEN TREGUAR NË EKSTRAKTIN E BANKËS



BANKA BOTËRORE  
UDHËZIMET E LIVRIMIT PËR PROJEKTET  
Maj 2006

DEPARTAMENTI I HUAVE  
1 maj 2006

E drejta e autorit<sup>©</sup> 2006

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore  
1818 H Street, N.W. Washington, D.C., 20433, USA  
Botim i parë: korrik 2006

Udhëzime për Lëvrimin për Projektet të Bankës Botërore

1 Maj 2006

## 1. Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtyre Udhëzimeve është përcaktimi i procedurave të Bankës për lëvrimin e shumave të huave për projektet<sup>1</sup>.

Në mënyrë të veçantë, Udhëzimet shpjegojnë (a) metodat e ndryshme që përdoren nga Banka për të lëvruar shumat e huasë, (b) kërkesat për tërheqjen nga Llogaria e Huasë, (c) tipet e dokumentacionit mbështetës që huamarrësit mund t'i kërkojnë për të demonstruar përdorimin e shumave të huasë për shpenzime të përshtatshme, (d) kriteret për hapjen e llogarive të destinuara, (e) termat dhe kushtet e zbatueshme për parapagimet, (f) tipet e veprimeve që Banka mund të ndërmarrë nëse ajo konstaton që shumat e huasë nuk nevojiten apo janë përdorur për qëllime të papërshtatshme, dhe (g) pasojën e shlyerjeve.

## 2. Metodatat e Lëvrimit

2.1 Banka vendos masa lëvrimi për operimin në konsultim me huamarrësin dhe merr në konsideratë, ndërmjet të tjerash, një vlerësim të menaxhimit financiar dhe masave të prokurimeve të huamarrësit, planin e prokurimit dhe nevojat e fluksit të parasë së operimit dhe eksperiencën e lëvrimit me huamarrësin.

2.2 Banka lëvront shumat nga Llogaria e Huasë e hapur për secilën hua sipas porosisë së huamarrësit, duke përdorur një ose disa metoda disbursimi të përcaktuara më poshtë, sipas përcaktimit nga Banka.

- a) **Rimbursimi:** Banka mund të rimbursojë huamarrësin për shpenzimet e përshtatshme të financimit në pajtim me Marrëveshjen e Huasë ("shpenzime të përshtatshme") që huamarrësi ka para-financuar nga burimet e veta.
- b) **Paradhënia:** Banka mund të bëjë si paradhënie shuma të huasë në llogarinë e destinuar të huamarrësit për të financuar shpenzime të përshtatshme siç kryhen dhe për të cilat do

<sup>1</sup> "Banka" përfshin IBRD-në dhe IDA-n; "hua" përfshin kredinë dhe grandin; "huamarrës" përfshin huamarrësin e një huaje të IBRD-së, kredie të IDA-s ose paradhënien e Instrumentit të Përgatitjes së Projektit dhe marrjen e një grandit; dhe "Marrëveshje Huaje" përfshin marrëveshjen me Bankën që parashikon një kredi, grand ose paradhënie. Këto Udhëzime Lëvrimi zbatohen për të gjitha huatë, kreditë, paradhëniet sipas Instrumentit të Përgatitjes së Projektit dhe grandet e financuara sipas Fondit të Zhvillimit Institucional dhe Instrumentit Global të Mjedisit përveç kur parashikohet ndryshe në Politikën Operacionale 10.20 Operacionet e Instrumentit Global të Mjedisit (në vazhdim). Këto Udhëzime zbatohen gjithashtu për grandet e ekzekutuara nga marrësi të financuara nga fondet e besimit përveç kur, në raste të veçanta, termat e marrëveshjes me donatorin parashikojnë kërkesa të ndryshme. Ato nuk zbatohen për huatë e Politikës së Zhvillimit.

të jepen dokumente mbështetëse në një datë të mëvonshme (shihni seksionin 5, "Llogaritë e Destinuar").

- c) **Pagesa e Drejtpërdrejtë:** Banka mund të bëjë pagesa me kërkesë të huamarrësit, drejtpërdrejt tek një palë e tretë (p.sh., furnitor, kontraktor, konsulent) për shpenzimet e përshtatshme.
- d) **Angazhimi i Veçantë:** Banka mund t'i bëjë pagesa të shumave një pale të tretë për shpenzime të përshtatshme sipas angazhimeve të veçanta të lidhura, me shkrim, me kërkesë të huamarrësit dhe sipas termave dhe kushteve të rëna dakord ndërmjet Bankës dhe huamarrësit.

### 3. Tërheqja e Shumave të Huasë

3.1 Nënshkrimet e Autorizuara para se shumat e huasë të mund të tërhiqen ose jepen nga Llogaria e Huasë përfaqësuesi i autorizuar i huamarrësit (sipër përcaktimit në Marrëveshjen e Huasë) duhet t'i japë Bankës (a) emrin(at) e nëpunësit(ve) të autorizuar të nënshkruajë aplikimet për tërheqje dhe aplikimet për një angazhim të veçantë (së bashku "Kërkesat") dhe (b) nënshkrimin(et) ekzemplare të vërtetuara të nëpunësit(ve). Huamarrësi duhet të tregojë qartësisht nëse kërkohet më shumë se një nënshkrim në Kërkesa dhe duhet të njoftojë menjëherë Bankën për çdo ndryshim në autoritetin e nënshkrimit.

3.2 **Kërkesat.** Kërkesat duhet t'i jepen Bankës në atë formë dhe të përfshijnë atë informacion që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme. Formularët e kërkesave janë të disponueshme online nga Faqja e Lidhjes me Klientin tek adresa <http://clientconnection.worldbank.org> ose nga Banka me kërkesë.

3.3 Për të realizuar tërheqje nga Llogaria e Huasë për paradhëniet, huamarrësi duhet të paraqesë një kërkesë origjinale të nënshkruar për tërheqje. Për tërheqjen nga Llogaria e Huasë për rimbursimet dhe pagesat e drejtpërdrejta dhe par raportimin për përdorimin e paradhënieve, huamarrësi duhet të paraqesë një kërkesë origjinale me shkrim për tërheqje së bashku me një kopje të dokumenteve mbështetëse (shihni seksionin 4 "Kërkesat për Dokumentacionin Mbështetës"). Për një angazhim të veçantë nga Llogaria e Huasë, huamarrësi duhet të paraqesë një kërkesë të nënshkruar për një angazhim të veçantë së bashku me një kopje të letrës së kredisë. Banka rezervon të drejtën të mos pranojë ose rishikojë kopjet dublikatë të Kërkesave dhe dokumenteve mbështetëse dhe, në diskrecionin e saj, mund të kthejë ose asgjësojë kopjet dublikatë.

3.4 **Paraqitja Elektronike.** Banka mund të autorizojë huamarrësin të përdorë mjete elektronike, në një mënyrë dhe sipas termave dhe kushteve të specifikuara nga Banka për të paraqitur Kërkesa dhe dokumentacion mbështetës Bankës. Kërkesat dhe dokumentacioni mbështetës të paraqitura në pajtim me këtë nën-seksion konsiderohet t'i jetë dhënë bankës për qëllimet e përmbushjes së kërkesave të nën-seksioneve 3.2 dhe 3.3 të këtyre Udhëzimeve.

3.5 **Vlera Minimale e Kërkesave.** Banka përcakton një vlerë minimale për Kërkesat për rimbursim, pagesat e drejtpërdrejta dhe angazhimin e veçantë. Banka rezervon të drejtën të mos pranojë Kërkesat që janë nën këtë vlerë minimale.



**3.6 Afati i Lëvrimit të Huasë.** Banka procedon me Kërkesat vetëm pasi të jetë deklaruar në fuqi Marrëveshja e Huasë në pajtim me termat e Marrëveshjes së Huasë. Shpenzimet për të cilat bëhen Kërkesat duhet të:

(a) **paguhen** (i) në ose pas datës së Marrëveshjes së Huasë, ose (ii) në rastin e veprimeve që lejojnë financim pas kryerjes, në ose pas datës më të parë të specifikuar në Marrëveshjen e Huasë për këtë qëllim; dhe

(b) **bëhen** në ose para datës së mbylljes së specifikuar ose përmendur në Marrëveshjen e Huasë ("Data e Mbylljes"), përveç kur është rënë dakord shprehimisht me Bankën.

**3.7 Afati i lëvrimit të huasë mbaron** në datën e fundit që caktohet nga Banka për marrjen nga Banka të kërkesave për tërheqjen dhe dokumentacionin mbështetës ("Data e Afatit të Lëvrimit"). Data e Afatit të Lëvrimit mund të jetë e njëjtë me datën e Mbylljes ose deri në katër muaj pas Datës së Mbylljes. Normalisht, për të mbështetur rregullisht përfundimin e projektit dhe mbylljen e Llogarisë së Huasë, Banka nuk pranon kërkesat për tërheqjen ose dokumentacionin mbështetës që merren pas Datës së Afatit të Lëvrimit. Huamarrësi duhet të informojë menjëherë Bankën për çdo vonesë të pritshme në zbatim apo çështje administrative të veçanta para këtyre datave. Banka njofton huamarrësin për çdo përgjashtim që Banka mund të bëjë për Datën e Afatit të Lëvrimit.

**3.8 Kushtet e Lëvrimit.** Nëse Marrëveshja e Huasë përmban një kusht lëvrimi për një kategori specifike shpenzimesh, Banka do të lëvrojë shumat e huasë për atë kategori vetëm pasi të jetë përmbushur kushti i lëvrimit dhe Banka të ketë njoftuar huamarrësin për këtë qëllim.

#### **4. Kërkesat për Dokumentacion Mbështetës**

**4.1** Huamarrësi i paraqet Bankës dokumentacion mbështetës për të treguar që shumat e huasë janë përdorur ose janë duke u përdorur për të financuar shpenzime të përshtatshme.

**4.2** Për angazhime të veçanta, banka tregtare i jep konfirmimin e saj drejtpërdrejt Bankës që kushtet për lirimin e pagesave të caktuara për tërheqje janë përmbushur.

**4.3 Tipet e Dokumentacionit Mbështetës.** Banka kërkon kopje të dokumenteve origjinale që provojnë shpenzime të përshtatshme ("Regjistra") ose raporte përmbledhëse të shpenzimeve ("Raporte Përmbledhëse") në atë formë dhe përmbajtje që mund të specifikojë Banka. Regjistrat përfshijnë dokumente të tilla si fatura dhe konfirmime. Një Raport Përmbledhës mund të jetë (a) raporti financiar i përkohshëm i paaudituar që kërket sipas Marrëveshjes së Huasë ("Raporti Financiar i Përkohshëm") ose (b) një pasqyrë shpenzimesh që përmbledh shpenzimet e përshtatshme të paguara gjatë periudhës së deklaruar ("Pasqyra e Shpenzimeve"). Në të gjitha rastet, huamarrësi është përgjegjës për mbajtjen e dokumenteve origjinale që provojnë shpenzimet e përshtatshme dhe që t'i ofrojnë ato për auditim dhe inspektim.

**4.4** Banka përcakton tipin e dokumentacionit mbështetës që huamarrësi duhet të paraqesë, duke marrë parasysh metodën e lëvrimit të zbatuar. dokumentacioni mbështetës mund të jetë si më

poshtë:

- (a) **Për kërkesat për rimbursim:** (i) Raporte të Përkohshme Financiare, (ii) Pasqyra shpenzimesh, (iii) Regjistra, ose (iv) Regjistra që kërkohen nga Banka për shpenzime specifike dhe Pasqyra Shpenzimesh për të gjitha shpenzimet e tjera;
- (b) **Për raportimin për përdorimin e paradhënies:** (i) Raporte të Përkohshme Financiare, (ii) Pasqyra shpenzimesh, (iii) Regjistra, ose (iv) Regjistra që kërkohen nga Banka për shpenzime specifike dhe Pasqyra Shpenzimesh për të gjitha shpenzimet e tjera;
- (c) **Për kërkesat për pagesa të drejtpërdrejta:** Regjistra;  
dhe
- (d) Çdo dokumentacion tjetër mbështetës që Banka mund të kërkojë duke njoftuar huamarrësin.

**4.5 Mosdhënia e Pasqyrave të Audituar Financiare.** Nëse huamarrësi nuk paraqet një prej Pasqyrave Financiare të kërkuara në pajtim me dhe brenda afatit kohor të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë, Banka, në diskrecionin e saj, vendos të mos pranojë kërkesat për tërheqje të mbështetura nga Raportet Përmbledhëse, edhe nëse këto raporte shoqërohen nga Regjistrat.

## 5. Llogari të Destinuara

**5.1** Huamarrësi mund të hapë një ose më shumë llogari të destinuar në të cilat Banka, me kërkesën e huamarrësit, mund të depozitojë shumat e tërhequra nga Llogaria e Huasë për qëllimin e pagesës së shpenzimeve të përshtatshme me realizimin e tyre ("Llogari e Destinuar"). Para se Banka të autorizojë hapjen e një Llogarie të Destinuar, huamarrësi duhet të ketë aftësi të përshtatshme administrative, kontrole të brendshme dhe procedura kontabiliteti dhe auditimi për të siguruar përdorimin efektiv të Llogarisë së Destinuar.

**5.2** Banka mund të vendosë të mos lejojë përdorimin e Llogarive të Destinuara në projekte të reja nëse huamarrësi nuk shlyen paradhëniet e pa-dokumentuara në Llogarinë e Destinuar të një huaje tjetër të dhënë ose garantuar nga huamarrësi brenda dy muajve pas Datës së Afatit të Lëvrimit për këtë hua.

**5.3 Tipi i Llogarisë së Destinuar.** Një Llogari e Destinuar mund të hapet në një nga dy mënyrat e përcaktuara më poshtë, sipas rastit, për veprimet përkatëse, sipas përcaktimit dhe njoftimit nga Banka.

- a) **Llogari e Ndarë:** kjo është një llogari e huamarrësit në të cilën mund të depozitohen vetëm shumat e huasë;  
ose
- b) **Llogari e Përbashkët:** kjo është një llogari e huamarrësit në të cilën mund të depozitohen shumat e huasë dhe shumat e tjera për financimin e operacionit (p.sh., burimet e huamarrësit dhe/ose financimi nga partnerë të tjerë të zhvillimit).

**5.4 Monedha e Llogarisë së Destinuar.** Llogaritë e Destinuara duhet të jenë në një monedhë të pranueshme për Bankën. Në vendet që janë një monedhë lirisht të konvertueshme, Llogaritë e



Destinuara duhet të mbahen në monedhën e huamarrësit ose çdo monedhë lirisht të konvertueshme. Banka mund të bjerë gjithashtu dakord për Llogaritë e Destinuara në monedhën lokale nëse, *ndërmjet të tjerash*, monedha e vendit (edhe nëse nuk është lirisht e konvertueshme) është e qëndrueshme dhe shpenzimet që duhet të financohen janë kryesisht në monedhën lokale. Huamarrësi mbulon të gjitha rreziqet në lidhje me luhatjet e këmbimit të huaj ndërmjet (a) monedhës së përcaktimit të huasë dhe asaj të Llogarisë së Destinuar të huamarrësit, dhe (b) monedhës së përcaktimit të Llogarisë së Destinuar dhe monedhës ose monedhave të shpenzimeve të projektit.

**5.5 Institucioni Financiar.** Llogaritë e Destinuara duhet të hapen dhe mbahen në një institucion të pranueshëm për Bankën sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën. Për të qenë të pranueshme për Bankën, institucioni financiar i propozuar nga huamarrësi duhet të përmbushë përgjithësisht kërkesat e mëposhtme:

- a) të jetë financiarisht i qëndrueshëm;
- b) të jetë i autorizuar të mbajë Llogarinë e Destinuar në monedhën e rënë dakord ndërmjet Bankës dhe huamarrësit;
- c) të auditohet rregullisht dhe të marrë raporte të pranueshme;
- d) të jetë në gjendje të ekzekutojë pa vonesë një numër të madh transaksionesh;
- e) të jetë në gjendje të kryejë një gamë të gjerë shërbimesh bankare në mënyrë të pranueshme;
- f) të jetë në gjendje të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të Llogarisë së Destinuar;
- g) të jetë pjesë e një rrjeti të pranueshëm bankar përkatës;  
dhe
- h) të vendosë tarifa të arsyeshme për shërbimet e veta.

5.6 Banka rezervon të drejtën të mos pranojë një institucion financiar për hapjen dhe/ose mbajtjen e Llogarisë së Destinuar nëse ku institucion ka ngritur ose ngre një pretendim për të kompensuar, bllokuar ose sekuestruar fondet e një huaje bankare të depozituara në një Llogari të Destinuar të mbajtur prej tij.

## 6. Termat dhe Kushtet e Zbatueshme për Paradhëniet

6.1 **Tavani.** Banka njofton huamarrësin për shumën maksimale të shumave të huasë që mund të depozitohen në Llogarinë e Destinuar ("Tavani"). Banka, në diskrecionin e saj mund të vendosë Tavanin si një (a) shumë fikse ose (b) në shumë që përshtatet herë pas here gjatë zbatimit të projektit të bazuar në parashikimet periodike të nevojave të fluksit të parasë së projektit.

6.2 **Kërkesat për Paradhënie.** Huamarrësi mund të bëjë kërkesë për një paradhënie në një shumë deri në nivelin e Tavanit minus shumën e mbledhur të atyre paradhënieve që janë marrë më para nga huamarrësi për të cilat huamarrësi nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës. Normalisht, për të mbështetur mbylljen e rregullt të Llogarisë së Huasë, Banka nuk derdh si paradhënie shuma nga huaja në Llogarinë e Destinuar pas Datës së Mbylljes.

**6.3 Shpeshësia e Raportimit të Shpenzimeve të Përshtatshme të Paguara nga Llogaria e Destinuar.** Huamarrësi raporton për përdorimin e shumave të huasë të derdhura si paradhënie në Llogarinë e Destinuar në intervalet e specifikuar nga Banka me njoftim drejtuar huamarrësit ("Periudha e Raportimit"). Huamarrësi duhet të sigurojë që të gjitha shumat e depozituara në Llogarinë e Destinuar të jenë të justifikuara dhe përdorimi të jetë raportuar para Datës së Afatit të Lëvritimit. Pas kësaj date, huamarrësi duhet t'i shlyejë Bankës çdo paradhënie që nuk është justifikuar dhe mbetet në llogarinë e Destinuar.

**6.4 Mbajtja e Paradhënieve.** Bankës nuk i kërkohet të bëjë ndonjë depozitë në Llogarinë e Destinuar nëse:

- (a) Banka konstaton që pagesa e depozitës do të rezultonte në tejkalimin e Tavanit (shih nën-seksionin 6.2 "Kërkesat për Paradhënie");
- (b) Banka nuk bindet që shpenzimet e projektit të planifikuara të huamarrësit justifikojnë depozitën. Banka, me anë të njoftimit drejtuar huamarrësit, mund të përshtatë shumën që ajo depoziton ose të mbajë më tej në Llogarinë e Destinuar deri sa të bindet që nevojat financiare të projektit kërkojnë depozita të tjera;
- (c) Huamarrësi nuk ndërmerr veprimet e kërkuara në pajtim me konstatimet e bëra nga Banka sipas nën-seksioneve 7.1 dhe 7.2 të këtyre Udhëzimeve;
- (d) Huamarrësi nuk jep një prej Pasqyrave Financiare që kërkohen në pajtim me dhe brenda afatit kohor të specifikuar në Marrëveshjen e Huasë;
- (e) Banka përcakton që të gjitha tërheqjet e shumave të huasë duhet të bëhen drejtpërdrejt nga huamarrësi nga Llogaria e huasë; ose
- (f) Banka ka njoftuar huamarrësin për synimin e saj të pezullojë plotësisht ose pjesërisht të drejtën e huamarrësit të bëjë tërheqje nga Llogaria e Huasë.

**6.5 Paradhëniet e Tejkaluara.** Nëse në një moment të caktuar Banka përcakton që një shumë e depozituar në Llogarinë e Destinuar nuk do të kërkohet të mbulojë pagesat e mëtejshme për shpenzimet e përshtatshme ("Shuma Shtesë"), në diskrecionin e saj, ajo mund t'i kërkojë huamarrësit të ndërmarrë një prej veprimeve të renditura më poshtë. Pas njoftimit të Bankës, huamarrësi duhet të ndërmarrë menjëherë veprimin e kërkuar:

- a) të japë provat e pranueshme për Bankën brenda një periudhe të specifikuar nga Banka që Shuma Shtesë të përdoret për të paguar shpenzimet e pranueshme. Nëse provat nuk jepen brenda afatit kohor të specifikuar, huamarrësi duhet të rimbursojë menjëherë Shumën Shtesë në Bankë; ose
- b) të shlyejë menjëherë Shumën Shtesë.

## **7. Shpenzime të Papërshtatshme**

**7.1 Shpenzime Përgjithësisht të Papranueshme.** Nëse Banka përcakton që një shumë e huasë është përdorur për të paguar një shpenzim që nuk është i pranueshëm në pajtim me Marrëveshjen e Huasë ("shpenzime të papranueshme"), Banka, në diskrecionin e saj, mund t'i kërkojë huamarrësit të ndërmarrë një prej veprimeve të renditura më poshtë. Pas njoftimit të Bankës, huamarrësi duhet të ndërmarrë menjëherë veprimin e kërkuar:



- a) Të shlyejë një shumë të barasvlershme në Bankë; ose
- b) si përjashtim, të paraqesë dokumentacion zëvendësues që provon shpenzime të tjera të pranueshme.

**7.2 Shpenzime të Papranueshme të Paguara nga Llogaria e Destinuar.** Nëse Banka konstaton që pagesa nga Llogaria e Destinuar nuk justifikohet nga provat e dhëna Bankës ose është bërë për shpenzime të papranueshme, Banka, në diskrecionin e saj, mund t'i kërkojë huamarrësit të ndërmarrë një nga veprimet renditura më poshtë: Pas njoftimit të Bankës, huamarrësi duhet të ndërmarrë menjëherë veprimin e kërkuar:

- a) Të paraqesë prova shtesë të kërkuara nga Banka;
- b) Të depozitojë një shumë të barasvlershme në Llogarinë e Destinuar;
- c) Të shlyejë një shumë të barasvlershme në Bankë; ose
- d) Si përjashtim, të paraqesë dokumentacion zëvendësues që provon shpenzime të tjera të pranueshme.

## 8. Shlyerjet

**8.1 Vendimi i Huamarrësit për Shlyerje.** Huamarrësi, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Bankës, shlyen të gjitha ose çdo shumë të huasë si depozitë në Llogarinë e Përcaktuar në Bankë për kreditimin Llogarisë së Huasë.

**8.2 Renditja e Shlyerjeve.** Banka përcakton nëse shlyerjet që i bëhen Bankës në pajtim me Seksionet 6 dhe 7 dhe nën-seksionin 8.1 të këtyre Udhëzimeve të Disbursimeve do të kreditohen në Llogarinë e Huasë për tërheqje të mëvonshme apo për anulim. Huamarrësit duhet të jenë të ndërgjegjshëm që shlyerjet e shumave të huasë mund të rezultojnë në tarifa për zëvendësimin dhe/ose shpenzime përpunimi për shumat për të cilat është konvertuar ose siguruar baza e normës së interesit ose monedha.

**8.3 Detyrime të tjera të Pacenuara nga Shlyerjet.** Shlyerjet e shumave të huasë nuk cenojnë asnjë mjet ligjor së Bankës sipas Marrëveshjes së Huasë.

**VENDIM**  
**Nr. 264, datë 3.4.2013**

**PËR ORGANIZIMIN E PUNËS PËR PËRAFRIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN  
E SË DREJTËS SË VENDOSJES DHE LËVIZJES SË LIRË TË SHËRBIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e planit të veprimit për përafrimin e legjislacionit në fushën e së drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve dhe transpozimin e direktivës “Për shërbimet në tregun e brendshëm 2006 123 EC”, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e metodologjisë për identifikimin, shqyrtimin, ndryshimin, shfuqizimin apo hartimin e akteve, ligjore e nënligjore, që lidhen me të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe përafrimin e tyre me legjislacionin e Bashkimit European në këtë fushë, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Miratimin e planit të trajnimit për punonjësit e administratës publike për ngritjen e kapaciteteve administrative në fushën e së drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve, sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



## ANEKSI 1 E DREJTA E VENDOSJES DHE LËVIZJA E LIRË E SHËRBIMEVE

### PLANI I VEPRIMIT PËR PËRAFRIMIN E LEGJISLACIONIT Gusht 2012

#### HYRJE

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin European është një proces mjaft dinamik, i cili varet nga përmbushja e kriterëve të Kopenhagenit miratuar në vitin 1993 dhe veçanërisht nga aftësia e Shqipërisë për t'u përshtatur me ndryshimet e vazhdueshme të *acquis*-së dhe transpozimin e saj të plotë në sistemin ligjor shqiptar.

Për këtë qëllim në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe në Partneritetin European të nënshkruara ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së janë parashikuar objektivat kryesore që duhet të përmbushen nga palët si edhe periudha kohore për plotësimin e tyre.

Me paraqitjen e kërkesës formale të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin European dhe Opinionin e Komisionit European për këtë qëllim në Nëntor 2010 procesi integruet i Shqipërisë ka hyrë në një fazë të re.

Ashtu siç theksohet edhe nga Komisioni European në Opinionin e tij Shqipëria ka bërë përparime në disa fusha, por ka ende punë për të bërë me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit me *acquis*-në e BE-së.

Për këtë qëllim, është e domosdoshme që të punohet për përcaktimin e prioritetëve dhe fushave kryesore për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në dokumentat e mësipërm.

Ky dokument përmbledh objektivat kryesore mbi bazën e të cilave do të punohet për përafrimin e plotë legjislacionit shqiptar në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve me legjislacionin european në këtë fushë si edhe masat konkrete që do të ndërmerren për këtë qëllim.

#### QËLLIMI:

Neni 70 i MSA-së parashikon detyrimin e Shqipërisë për të përafruar legjislacionin e saj me atë të BE-së si edhe detyrimin e saj për vënien në zbatim të këtij legjislacioni. Gjithashtu, Partneriteti European i nënshkruar ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së në shkurt 2008 parashikon detyrimet afatshkurtra dhe afatmesme të Shqipërisë në këtë drejtim.

Tregu i brendshëm dhe katër liritë e tij, ashtu siç janë parashikuar edhe nga Traktati<sup>1</sup>, është fusha kryesore ku po punohet për këtë qëllim.

Në këtë kuadër, qëllimi kryesor i kësaj reforme është përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve<sup>2</sup> me *acquis*-në e BE-së në këtë fushë.

Kështu, për sa i përket të drejtës së vendosjes<sup>3</sup>, Shqipëria ka detyrimin që nga momenti i hyrjes në fuqi të MSA-së<sup>4</sup> të garantojë të drejtën e vendosjes për kompanitë e themeluara në BE duke iu ofruar atyre të njëjtin trajtim si edhe kompanive shqiptare.

<sup>1</sup> Katër liritë themelore të tregut të brendshëm të parashikuara nga Traktati për Funkcionimin e Bashkimit European (neni 45-66) janë (i) lëvizja e lirë e mallrave; (ii) lëvizja e lirë e personave; (iii) lëvizja e lirë e shërbimeve dhe (iv) lëvizja e lirë e kapitaleve.

<sup>2</sup> Neni 49-59 i MSA-së.

<sup>3</sup> Neni 49-55 i Traktatit

<sup>4</sup> Neni 50, pika 1 i MSA-së.

Në këtë drejtim, ashtu siç theksohet edhe në raportin e Komisionit European të nëntorit 2010 legjislacioni shqiptar në këtë fushë është jo-diskriminues dhe, si rezultat, në përputhje me *acquis communautaire*.

Ndërkohë, neni 50, pika 4 e MSA-së parashikon një periudhë tranzitore prej pesë vjetësh për sa i përket të drejtës së vendosjes të personave me qëllim ushtrimin e aktivitetit ekonomik si persona të vetëpunësuar.

Për sa më sipër, duhet theksuar se ushtrimi i aktivitetit si persona të vetëpunësuar nga shtetasit e BE-së dhe shtetasit shqiptarë reciprokisht, lidhet ngushtë me njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale siç është parashikuar edhe nga Direktiva 2005/36, e cila është në proces ndryshimi nga Komisioni.

Po kështu, për sa i përket të drejtës së vendosjes, Shqipëria aplikon zbatimin e disa kriterëve specifike dhe kufizimeve për kompanitë komunitare në disa fusha si p.sh. transport detar dhe ajror, noteri, përmbarrim gjyqësor, shërbime financiare etj.

E drejta e Shqipërisë për të aplikuar kriterë specifike apo kufizime lidhur vendosjen dhe ofrimin e shërbimeve<sup>5</sup> nga ana e kompanive komunitare parashikohet edhe në nenin 56 të MSA-së ku përcaktohet një periudhë tranzitore prej pesë vjetësh për këtë qëllim. Në çdo rast, këto lloj kufizimesh duket të jenë jo-diskriminuese, të arsyeshme, të domosdoshme dhe të justifikueshme.

Gjithsesi, duhet theksuar se pesë vjet pas hyrjes në fuqi të MSA-së këto kufizime mund të mbahen vetëm pasi të jetë marrë autorizimi i Këshillit të Stabilizim-Asociimit për këtë qëllim.

Ndërkohë, për sa i përket **lëvizjes së lirë të shërbimeve**, neni 57, pika 3 i MSA-së parashikon një periudhë tranzitore prej pesë vjetësh për liberalizimin gradual të tyre nga të dyja palët.

Gjithashtu, legjislacioni shqiptar nuk është në përputhje me *acquis* në këtë fushë për sa i përket **shërbimeve ndër-kufitare**, duke qenë se këto lloj shërbimesh nuk parashikohen fare, ashtu si janë parashikuar nga neni 56 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit European.

Në çdo rast, duhet pasur parasysh se parashikimi i këtyre lloj shërbimeve nuk është një detyrim para-anëtarësimi për Shqipërinë dhe vetëm pas anëtarësimit me të drejta të plota në BE dhe njohjes reciproke të kualifikimeve do të mund të ofrohen lirisht këto lloj shërbimesh.

Nga sa më sipër, është e nevojshme përcaktimi i objektivave kryesore mbi bazën e të cilave do të punohet për përafrimin e legjislacionit në fushat e sipërpërmendura.

#### **OBJEKTIVAT KRYESORE:**

Puna për përafrimin e legjislacionit në këtë fushë do të kryhet mbi bazën e objektivave afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë si më poshtë:

##### **Objektiva afatshkurtra: Krijimi i kuadrit institucional.**

- (i) Përcaktimi i kuadrit institucional, ngritja e grupeve të punës dhe përcaktimi i personave përgjegjës për rishikimin e legjislacionit dhe transpozimin e Direktivës së Shërbimeve sipas fushave dhe institucioneve specifike.

<sup>5</sup> Liria për të ofruar shërbime—Neni 56-62 i Traktatit



- (ii) Ngritja e kapaciteteve administrative në këtë fushë nëpërmjet trajnimeve dhe informimit të vazhdueshëm të personave dhe institucioneve të përfshira në proces.
- (iii) Hartimi i metodologjisë, kriterëve dhe pikave kryesore që do të përdoren për rishikimin e legjislacionit horizontal dhe sektorial me qëllim përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë me Direktivën e Shërbimeve dhe nenet përkatëse të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.
- (iv) Identifikimi dhe inventarizimi i acquis-së në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve.

**Shiko bashkëlidhur:** Tabela 1: Aktivitetet e Detajuara për periudhën shtator 2012-dhjetor 2013.

#### **Objektivat afatmesme: Rishikimi i legjislacionit**

- (i) Analizimi i të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë sipas fushave dhe përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë të tyre me Direktivën e Shërbimeve dhe nenet përkatëse të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian si edhe të problematikave të legjislacionit shqiptar në këtë fushë.
- (ii) Analizimi dhe krahasimi i përjasjeve të shteteve anëtare të BE-së për transpozimin e Direktivës së Shërbimeve me qëllim zgjedhjen e modelit më të përshtatshëm për Shqipërinë.
- (iii) Ndryshimi i akteve ligjore apo nënligjore në fuqi dhe hartimi e miratimi i akteve të reja me qëllim përafrimin e tyre me acquis-në e BE-së.
- (iv) Krijimi dhe vënia në funksionim e Single Points of Contact sipas kuptimit të dhënë nga Direktiva e Shërbimeve.

**Shiko bashkëlidhur:** Tabela 1: Aktivitetet e Detajuara për periudhën shtator 2012-dhjetor 2013.

#### **Objektivat afatgjata: Përafrimi i plotë i legjislacionit**

- (i) Transpozimi të plotë të Direktivës së Shërbimeve në sistemin ligjor shqiptar duke përcaktuar një periudhë tranzitore për disa prej dispozitave të kësaj direktive të cilat nuk mund të hyjnë në fuqi menjëherë.
- (ii) Përcaktimi në legjislacionin shqiptar të konceptit të shërbimeve ndërkufitare dhe kushteve për ofrimin e tyre.

### **REZULTATET:**

Në përputhje me objektivat e mësipërme reforma që do të ndërmerret nga ana e Qeverisë Shqiptare për përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me acquis-në në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve synon të arrijë rezultate konkrete si më poshtë:

#### **Afatshkurtra: Krijimi i kuadrit institucional.**

Gjatë kësaj periudhe do të punohet për përcaktimin e kuadrit të nevojshëm institucional për drejtimin, koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të nevojshme për përafrimin e legjislacionit në fushat e mësipërme.

Për këtë qëllim, do të ngrihet një **Grup Ndërinstitucional Pune (GNP)** për kapitullin 3, transpozimin e Direktivës së Shërbimeve dhe përafrimin e legjislacionit ku do të marrin pjesë përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Integrimit, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme.

Me qëllim shmangien e dublimit të institucioneve dhe përplasjeve të mundshme ndërmjet kompetencave të tyre, ky grup do të funksionojë edhe në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 183, dt. 11.12.2009 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të Acquis Communautaire, përfshirë dhe kapitujt për kriterin politik dhe atë ekonomik" duke kryer të gjitha detyrat dhe funksionet e përcaktuara nga ky urdhër.

GNP do të hartojë dhe miratojë metodologjinë mbi bazën e të cilës do të kryhet puna e mësipërme si edhe do të përcaktojë Grupet Sektoriale të Punës (GSP) për identifikimin, rishikimin dhe ndryshimin e legjislacionit në fushat përkatëse me qëllim përafrimin e tij me acquis-në e BE-së. Secili Grup Sektorial Pune do të raportojë rezultatet Grupit të Rishikimit të Legjislacionit (GRL), i cili do të përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (DPIT), Ministrisë së Integrimit Europian, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Qendrës Kombëtare të Licencimit, një jurist nga Këshilli i Ministrave dhe një jurist nga Ministria e Drejtësisë.

Gjithashtu, Drejtorët e Drejtorive të Integrimit Europian në ministritë e linjës do të jenë pikat e kontaktit për institucionet e tyre dhe njëkohësisht do të garantojnë rishikimin e legjislacionit në fushat e tyre.

Njëkohësisht, përveç neneve përkatëse të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe Direktives së Shërbimeve (2006/123) që janë dokumentat bazë mbi të cilat rregullohet e drejta e vendosjes dhe lëvizja e lirë e shërbimeve, do të identifikohet dhe analizohet e gjithë acquis e BE-së në këtë fushë, përfshirë këtu edhe vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

METE/DPIT në bashkëpunim me GIZ po punon për përgatitjen e një plani të detajuar trajnimi me qëllim familjarizimin e personave dhe institucioneve përgjegjëse me konceptet e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime si edhe njohjen e tyre me eksperiencat e vendeve anëtare të BE-së për transpozimin e Direktivës së Shërbimeve.

Së fundi, GNP do të miratojë aktivitetet e detajuara për objektivat afatmesme me qëllim fillimin e punës për rishikimin e legjislacionit në brenda 2013-ës.

#### **Afatmesme: Rishikimi i legjislacionit**

Gjatë kësaj faze, puna kryesore do të fokusohet në identifikimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo, rregullojnë të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë.

Rishikimi i legjislacionit do të bëhet në dy faza: (i) analizimi i të gjitha akteve legislative në një fushë të caktuar nga vetë institucioni përgjegjës dhe përcaktimi i mospërputhshmërive të tij me acquis-në në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve, dhe (ii) rishikimi i raportit të GST nga GRL, verifikimi i gjetjeve dhe përgatitja e raportit final duke përfshirë edhe propozimet konkrete për ndryshimin apo shfuqizimin e akteve legislative të caktuara.



Një pjesë shumë e rëndësishme e procesit në këtë fazë do të jetë edhe analiza krahasimore e akteve ligjore dhe metodologji të përdorura nga vendet anëtare të BE-së me qëllim zgjedhjen e sistemit më të përshtatshëm për transpozimin e Direktivës së Shërbimeve në Shqipëri.

Gjatë kësaj kohe do të punohet edhe për ngritjen e Pikave të Vetme të Kontaktit, bazuar në eksperiencën e vendeve të BE-së në këtë drejtim. Për këtë, do të kërkohet edhe asistencë e Komisionit Europian dhe sugjerimet e tyre.

#### **Afatgjata: Përafrimi i plotë i legjislacionit**

Duke pasur parasysh se qëllimi final i kësaj reforme është përafrimi i plotë i legjislacionit dhe transpozimi i Direktivës së Shërbimeve duhet theksuar se ky qëllim do të arrihet përfundimisht vetëm me praninë e Shqipërisë si vend anëtar i BE-së.

Gjithsesi, pavarësisht nga ecuria e procesit të integritit, GNP në bashkëpunim me institucionet e tjera, grupet e interesit dhe Komisionin Europian, në përfundim të procesit të rishikimit të legjislacionit do të përcaktojë mënyrën e transpozimit të Direktivës së Shërbimeve nëpërmjet hartimit të një ligji të ri horizontal apo amendimit të legjislacionit ekzistues si edhe për përcaktimin e konceptit të shërbimeve ndërkufitare në legjislacionin shqiptar.

Për sa më sipër, duhet theksuar se, pavarësisht transpozimit të Direktivës së shërbimeve në legjislacionin shqiptar, disa prej dispozitave të saj do të hyjnë në fuqi vetëm në datën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

**Tabela 1**  
**AKTIVITETET E DETAJUARA PËR PERIUHDHËN SHTATOR 2012- DHJETOR 2013**

| Nr. | Aktiviteti                                                                                                                            | Institucioni<br>Përgjegjës | Afati        | Rezultatet                                                                                                                                          | Komente                                                                                                                                                                                                   |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|--------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.  | Krijimi i kuadrit institucional për përafrimin e legjislacionit për të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve          | METE<br>MIE                | Dhjetor 2012 | Urdhër i kryeministrit për ngritjen e kuadrit institucional                                                                                         | Kjo përfshin:<br><ul style="list-style-type: none"> <li>Grupin Ndërinstitucional të Punës (GNP)</li> <li>Grupin e Rishikimit të Legjislacionit (GRL)</li> <li>Grupet Sektoriale të Punës (GSP)</li> </ul> |
| 2.  | Miratimi i planit të trajnimit mbi të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime mbi bazën e specifikave për secilën fushë | GNP në bashkëpunim me GSP  | Dhjetor 2012 | Plani i trajnimit VKM për organizimin e punës për përafrimin e legjislacionit në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime |                                                                                                                                                                                                           |



|    |                                                                                                                                                   |                           |              |                                                                                                                                                       |  |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|--------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| 3. | Miratimi i metodologjisë:<br>(i) Njohja dhe vlerësimi i metodologjive të përdorura nga vendet e BE-së për transpozimin e direktivës së Shërbimeve | GNP në bashkëpunim me GSP | Dhjetor 2012 | Metodologjia<br><br>VKM për organizimin e punës për përafrimin e legjislacionit në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime |  |
|    | (ii) Përcaktimi i kriterëve dhe pikave kryesore mbi bazën e të cilave do të bëhet rishikimi i legjislacionit                                      | GNP                       | Dhjetor 2012 |                                                                                                                                                       |  |
|    | (iii) Konsultimi i vazhdueshëm me institucionet e përfshira në proces dhe personat e interesuar                                                   | GNP                       | Vazhdimisht  |                                                                                                                                                       |  |
|    | (iv) Konsultim i vazhdueshëm me DG-Market                                                                                                         | GNP                       | Vazhdimisht  |                                                                                                                                                       |  |

|    |                                                                                                                                                                                                               |                                                |                            |                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------|----------------------------|---------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 4. | Identifikimi dhe inventarizimi i acquis-së së BE-sënë fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime                                                                                      | GSP                                            | Shtator 2012-<br>Mars 2013 | Raportet e GSP-ve sipas fushave | Azhornimi i LGA nga eksperti                                                                                                                                                                                                                                         |
| 5. | Hartimi dhe miratimi i formatit (kartelës) për verifikimin e shkallës së përputhshmërisë së çdo akti ligjor apo nënligjor me acquis-në në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve | GNP                                            | Dhjetor 2012               | Formati përkatës                | Formati (kartela) do të përfshijë në mënyrë të përmblendhur të gjitha pikat kryesore (parimet e përgjithshme, kriteret, kufizimet etj) të parashikuara në acquis-në e BE-së për të cilat do të verifikohet përputhshmëria e legjislacionit shqiptar.                 |
| 6. | Zhvillimi i trajnimeve sipas planit të miratuar                                                                                                                                                               | DPIT                                           | Shtator 2012-<br>Mars 2013 |                                 | Trajnimet e parashikuara do të zhvillohen me mbështetjen e GIZ. Një pjesë e tyre (në disa fusha) do të zhvillohen nga eksperti ligjor i kontraktuar nga GIZ për Kapitullin 3, ndërkohë që për pjesën tjetër mund të jetë e nevojshme kërkesa e asistencës nga TAIEK. |
| 7. | FAZA I<br>Rishikimi i legjislacionit                                                                                                                                                                          | METE, MIE,<br>MASH, MITIK,<br>MD, MF, MB, MSH, | Janar-Qershor<br>2013      | Raportet sipas sektorëve        | Rishikimi sektorial do të bëhet njëkohësisht nga të gjitha institucionet për të lejuar më pas një                                                                                                                                                                    |



|                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                           |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| shqiptar që rregullon të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe përcaktimi i shkallës së përputhshmërisë me acquis-në e BE-së në këtë fushë- | MM, MPPT<br>MTKRS, MBUMK,<br>MPÇSSHB,<br>MMPAU, AKEP,<br>KKRT, AMF, BSH,<br>QKR, QKL, ERE,<br>APP, NJMLF, çdo institucion tjetër veprimtaria e të cilit prek në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime. |  |  | <p>diskutim të secilit sektor dhe GSP me GRL</p> <p>Sektorët për të cilat do të bëhet rishikimi i legjislacionit janë:(i) Shërbimet financiare, (ii) Transport, (iii) Shërbimet arsimore, (iv) Shërbimet shëndetësore dhe veterinarë, (v) Tatimet dhe sigurimet shoqërore, (vi) Profesionet e rregulluara, (vii) Prokurimet dhe koncesionet, (viii) Skemat e autorizimit dhe regjistrimi, (ix) Lojërat e fatit, (x) Shërbimet postare, (xi) Shërbimet turistike, (xii) Shërbimet e akomodimit dhe ushqimit, (xiii) Mbrojtja e mjedisit, (xiv) Shërbimet e agjencive të punësimit, (xv) Shërbimet për sigurinë fizike, (xvi) Shërbimet audio vizuale, (xvii) Shërbimet e komunikimit elektronik, (xviii) Shërbimet e telekomunikacionit, (xix) Shërbimet sportive, (xx) Shërbimet e asistencës sociale, (xxi) Tregtia e mallrave me përdorim të dyfishtë, (xxii) Shërbimet ligjore</p> |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

|    |                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                    |                                                                      |                                                                   | (profesionet)                                                                                                                                                   |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    | Vlerësimi i nevojës për rishikimin e legjislationit që rregullon të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve në pushtetin vendor                                                                | MB, Autoritetet e Pushtetit Vendor (Qarqe, Bashki, Komuna), Shoqata e Bashkive, Shoqata e Komunave | Prill-Qershor 2013                                                   | Raport i GRL për domosdoshmërinë e rishikimit                     |                                                                                                                                                                 |
| 8. | <b>FAZA II</b><br>Rishikimi i legjislationit shqiptar që rregullon të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe përcaktimi i shkallës së përputhshmërisë me acquis-në e BE-së në këtë fushë. | GRL                                                                                                | Qershor-Dhjetor 2013                                                 | Raportet e GRL për secilin nga sektorët me rekomandimet përkatëse |                                                                                                                                                                 |
| 9. | Ndryshimi i akteve ligjore apo nënligjore në fuqi dhe hartimi e miratimi i akteve të reja me qëllim përafrimin e tyre me acquis-në e BE-së.                                                                  | GSP<br>GNP                                                                                         | Afati do të jetë në varësi të vlerësimit dhe rekomandimeve përkatëse | Draftet ligjore dhe nënligjore përkatëse sipas sektorëve          | Pas miratimit të raporteve të GRL nga GNP do të fillojë puna e GSP për hartimin e ndryshimeve apo akteve të reja në përputhje me rekomandimet e dhëna në raport |



|     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                      |                                                                                                                        |                                    |  |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--|
| 10. | <p>Krijimi dhe vënia në funksionim e Single Points of Contact sipas kuptimit të dhënë nga Direktiva e Shërbimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional për ofrimin e informacionit online në kuptimin e Direktivës së Shërbimeve</li><li>• Hartimi i raportit me propozimet përkatëse për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe krijimin e infrastrukturës së re nëse është e nevojshme</li><li>• Bëria funksionale e Single Point of Contact</li></ul> | GSP, GRL, GNP, AKSHI | <p>Nëntor 2012-<br/>Mars 2013</p> <p>Prill-Qershor<br/>2013</p> <p>Afati është në funksion të raportit të mësipërm</p> | Miratimi i kuadrit ligjor përkatës |  |
| 11. | Analizimi dhe krahasimi i përfaqësive të shteteve anëtare të BE-së për transpozimin e Direktivës së Shërbimeve me                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | GRL<br>GNP           | Janar-Qershor<br>2013                                                                                                  |                                    |  |

|     |                                                                     |     |                        |  |  |  |
|-----|---------------------------------------------------------------------|-----|------------------------|--|--|--|
|     | qëllim zgjedhjen e modelit<br>më të përshtatshëm për<br>Shqipërinë. |     |                        |  |  |  |
| 12. | Hartimi dhe miratimi i<br>aktiviteteve të detajuara<br>afatgjata.   | GNP | Nëntor-Dhjetor<br>2013 |  |  |  |



## Aneksi 2

### Metodologjia për identifikimin, shqyrtimin, ndryshimin, shfuqizimin apo hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me të drejtën e vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve

Në kuadër të përgatitjes për anëtarësim në Bashkimin Europian, Shqipëria ka detyrimin për ta përafruar legjislacionin e brendshëm me Acquis-në e BE-së në fushën e të drejtës së vendosjes dhe të lëvizjes së lirë të shërbimeve.

Për shkak të natyrës horizontale të një pjese të Acquis-së së BE-së, ky proces do të zhvillohet në disa faza dhe kërkon një nivel të lartë rigoroziteti dhe qëndrueshmërie. Në disa raste, legjislacioni i brendshëm që harmonizon plotësisht legjislacionin shqiptar me Acquis-në e BE-së do të hyjë në fuqi vetëm në datën e anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Kjo metodologji, parashtrohet qëllimet kryesore dhe hapat që duhen ndjekur nga Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) dhe Grupi për Rishikimin e Legjislacionit (GRL).

Puna për përafrimin e legjislacionit në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve do të zhvillohet sipas fazave të mëposhtme:

- **Faza 1:** Ngritja e Grupit Ndërinstitucional të Punës dhe e Grupit për Rishikimin e Legjislacionit.
- **Faza 2:** Ngritja e kapaciteteve administrative-trajnimi i anëtarëve të GNP, GRL dhe Grupeve Sektoriale të Punës (GSP).
- **Faza 3:** Identifikimi i legjislacionit përkatës shqiptar dhe rishikimi i tij në lidhje me përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së për të drejtën e vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve.
- **Faza 4:** Vlerësimi i ndikimit rregullator dhe përgatitja e një plani pune për ndryshimin apo shfuqizimin e legjislacionit shqiptar ose hartimin e akteve të reja ligjore dhe nënligjore si edhe hartimi i një strategjie për përgatitjen e negociatave për anëtarësim në kuadër të Kapitullit 3<sup>1</sup>.
- **Faza 5:** Hartimi i një ligji të ri horizontal ose amendimi i akteve ligjore ekzistuese për të zbatuar në praktikë Direktivën e Shërbimeve 2006/123/KE

Me t'u ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës, Grupi për Rishikimin e Legjislacionit dhe Grupet Sektoriale të Punës, Drejtoria e Politikave të Integritit Tregtar (DPIT) në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës duhet të hartojë një mekanizëm për përditësimin e rregullt të gjithë grupeve të interesit në lidhje me zhvillimet e reja në fushën e legjislacionit të BE-së. Legjislacioni i ri dhe jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë do të shpërndahen rregullisht dhe për to mund të bëhen edhe trajnime.

**Faza 1** do të realizohet në përputhje me Aneksin 1 të këtij Vendimi.

**Faza 2** do të realizohet në përputhje me Planin e Trajnimit të parashikuar në Aneksin 4 të këtij Vendimi.

**Faza 3** do të realizohet në përputhje me hapat e mëposhtëm:

---

<sup>1</sup> Në këtë fazë, një listë masash të cilat, megjithëse përbëjnë pengesë për të drejtën e vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve, mund të justifikohen mbi bazën e derogimeve eksplicite të parashikuara në nenet 52 dhe 62 të TFEU-së si edhe të kërkesave imperative me interes të përgjithshëm të zhvilluara në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë.

## Hapi 1: Identifikimi i legjislacionit shqiptar dhe vlerësimi paraprak i tij

Gjatë kësaj faze do të bëhet identifikimi dhe mbledhja e të gjithë legjislacionit shqiptar që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo në të drejtën e vendosjes apo lëvizjen e lirë të shërbimeve. Këtu përfshihen të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore si edhe i gjithë legjislacioni përkatës vendor dhe rregullat e brendshme të shoqatave profesionale. Pas bërjes së këtij inventari, fillon hapi 2.

## Hapi 2: Verifikimi i përputhshmërisë/mospërputhshmërisë

Për të verifikuar përputhshmërinë/mospërputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me Acquis-në e BE-së për të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve, është e nevojshme që fillimisht të përcaktohet se cila prej lirive të tregut të brendshëm aplikohet për aktin në shqyrtim (ose e drejta e vendosjes, ose lëvizja e lirë e shërbimeve) (diagrami 1).

### 1. E drejta e Vendosjes:

- (i) Në rast se një masë e caktuar ka të bëjë me **të drejtën e vendosjes**, duhet verifikuar nëse ka ndonjë akt të legjislacionit dytësor të BE-së që zbatohet në këtë rast apo nëse zbatohen nenet 9-15 të Direktivës së Shërbimeve. Nëse asnjëra prej këtyre nuk zbatohet, atëherë zbatohet neni 49 i TFBE-së dhe jurisprudenca përkatëse.<sup>2</sup> (diagrami 2)
- (ii) Nëse një masë e caktuar ka të bëjë me një akt legjislacioni dytësor të BE-së, atëherë duhet të verifikohet nëse është bërë përafrimi. Për çështjet që nuk janë objekt rregullimi nga një akt i tillë mund të zbatohet Direktiva e Shërbimeve, neni 49 i TFBE-së dhe jurisprudenca përkatëse sipas rastit.
- (iii) Nëse një masë e caktuar përbën objekt të neneve 9-15 të Direktivës së Shërbimeve 2006/123/KE (e drejta e vendosjes së ofruesve të shërbimeve), atëherë duhet bërë analiza e parashikuar nga këto dispozita. (diagrami 3)
- (iv) Nëse një masë nuk është objekt as i legjislacionit specifik dytësor, as i neneve 9-15 të Direktivës së Shërbimeve 2006/123/KE, atëherë zbatohet neni 49 i TFBE-së dhe jurisprudenca përkatëse. Si hap i parë, duhet të verifikohet nëse kjo masë përbën pengesë për të drejtën e vendosjes. Nëse është kështu, në hapin tjetër duhet të identifikohet arsyeja e shmangies/derogimit, pas së cilës kryhet testi i proporcionalitetit. (diagrami 4)

### 2. Lëvizja e lirë e shërbimeve:

- (i) Në rast se një masë e caktuar është objekti **lëvizjes së lirë të shërbimeve**, si hap i parë duhet të verifikohet nëse ajo ka të bëjë me lirinë për të ofruar apo për të marrë shërbime. (diagrami 5)
- (ii) Nëse kjo masë është objekt i lirisë për të ofruar shërbime, në hapin tjetër duhet verifikuar nëse masa në fjalë ka të bëjë me ndonjë akt legjislacioni specifik dytësor të

<sup>2</sup> Verifikimi i përputhshmërisë sa i takon rezidencës për personat fizikë që përfitojnë nga e drejta e vendosjes bëhet në kuadër të Kapitullit 2, duke qenë se këta persona rregullohen nga Direktiva 2004/38/KE për lëvizjen e lirë të personave.



- BE-së apo me Direktivën e Shërbimeve 2006/123/KE apo vetëm me nenin 56 të TFBE-së dhe jurisprudencën përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë.
- (iii) Nëse kjo masë ka të bëjë me një legjislacion specifik dytësor të BE-së, atëherë duhet të verifikohet nëse është bërë përafrimi; duhet të verifikohet përputhshmëria me Direktivën e Shërbimeve 2006/123/KE, për aq sa kjo e fundit mund të gjejë zbatim apo me nenin 56 të TFBE-së.
  - (iv) Nëse kjo masë nuk ka të bëjë me ndonjë akt legjislacioni specifik dytësor të BE-së, por lidhet me Direktivën e Shërbimeve 2006/123/KE, duhet të verifikohet përputhshmëria me këtë të fundit.
  - (v) Nëse një masë e caktuar nuk ka të bëjë me ndonjë legjislacion dytësor, atëherë duhet të verifikohet përputhshmëria me nenin 56 të TFBE-së

Për të gjitha masat që bien ndesh me Direktivën e Shërbimeve 2006/123/KE dhe/ose me nenet 49 dhe 56 të TFBE-së, duhet të identifikohen arsyet e shmangieve/derogimeve të lejuara.

### **Hapi 3: Aplikimi i testit të proporcionalitetit (në rast se ka mospërputhshmëri në pamje të parë)**

Si pika reference për këtë qëllim do të përdoren “Manuali për përafrimin e legjislacionit shqiptar me Acquis-në e BE-së për të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve” (përgatitur nga GIZ-ja) dhe “Manuali për implementimin e Direktivës së Shërbimeve” (përgatitur nga Komisioni European).

**Faza 4** do të realizohet në përputhje me hapat e mëposhtëm:

**Hapi 1:** Vlerësimi i ndikimit rregullator

**Hapi 2:** Përgatitja e një plani pune për ndryshimin apo shfuqizimin e legjislacionit shqiptar ose hartimin e akteve të reja ligjore dhe nënligjore


**Hapi 3:** Hartimi e një strategjie për përgatitjen e negociatave për anëtarësimin.

**Faza 5:** Hartimi i një ligji të ri horizontal ose amendimi i akteve ligjore ekzistuese për të zbatuar në praktikë Direktivën e Shërbimeve 2006/123/KE dhe miratimi në Kuvend. Disa dispozita mund të hyjnë në fuqi përpara anëtarësimit në Bashkimin European, ndërsa disa të tjera mund të hyjnë në fuqi vetëm në datën e hyrjes në fuqi të Traktatit të Anëtarësimit.

## Diagrami 1

Verifikimi i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me Acquis-në e BE-së

### Hapi 1







## Diagrami 2

Verifikimi i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me Acquis-në e BE-së

### Hapi 2




### Diagrami 3 Verifikimi i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me Acquis-në e BE-së Hapi 3






**Diagrami 4**  
**Verifikimi i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me Acquis-në e BE-së**  
**Hapi 3**



**Diagrami 5**  
**Verifikimi i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me Acquis-në e BE-së**  
**Hapi 3**





### Aneksi 3

#### **Plani i trajnimit për punonjësit e administratës publike për ngritjen e kapaciteteve administrative në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve**

1. Të gjithë punonjësit e angazhuar në procesin rregulluar me këtë Vendim, duhet të marrin pjesë në sesionet e trajnimit.
2. Veprimtaritë e trajnimit përbëhen nga një paketë standarde trajnimesh që do të zhvillohen gjatë vitit 2012 si edhe nga trajnime të posaçme (ad hoc) që mund të organizohen sipas nevojës.
3. Paketa standarde e trajnimeve mund të përsëritet gjatë gjithë kohëzgjatjes së këtij procesi, nëse ka ndryshime të punonjësve në ministritë dhe autoritetet përkatëse.
4. Rast pas rasti do të organizohen trajnime të posaçme (ad hoc) mbi zhvillimet më të fundit të legjislacionit të BE-së.
5. Paketa standarde e trajnimeve përbëhet nga:
  - a) Trajnim i përgjithshëm për legjislacionin e BE-së në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve.
  - b) Trajnime të specializuara për legjislacionin e BE-së në fushat që mbulon ky proces, duke përfshirë edhe ushtrime simuluese për rishikimin e legjislacionit.
6. Materialet e trajnimit përfshijnë:
  - a) Leksione,
  - b) Legjislacionin përkatës të BE-së dhe legjislacionin e brendshëm,
  - c) Jurisprudencën përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë,
  - d) Udhëzuesin për zbatimin e Direktivës së Shërbimeve,
  - e) Manualin për të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve.
7. Trajnimet do të zhvillohen në përputhje me tabelën e mëposhtme:

PLANI I TRAJNIMIT 2012-2013

| Fusha e trajnimit                                                                                                   | Periudha kohore | Institucionet/personat përgjegjës                                         | Komente                                                                                       | Lektor        |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|---------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| Takim paraprak:<br>Prezantimi i procesit në përgjithësi                                                             |                 | Zëvendësministër/Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve të përfshira | Me qëllim shfrytëzimin e konsulencës të paguar nga GIZ këto aktivitete janë zhvilluar tashmë. | Adam Lazowski |
| ToT intensive lidhur me të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve                                    |                 | Një grup personash që do të merren direkt me rishikimin e legjislacionit  | Ndërkohë mendohet që më vonë do të zhvillohen edhe aktivitete të tjera si këto.               | Adam Lazowski |
| Parimet e analizës së boshllëqeve/mangësive ligjore me Acquis-në e BE-së për kapitullin 3 dhe mangësitë e vërejtura | Nëntor 2012     | Të gjitha institucionet                                                   |                                                                                               | Adam Lazowski |
| Transport                                                                                                           | Dhjetor 2012    | Grupet e punës për transportin                                            | Të gjitha llojet e transportit                                                                | Adam Lazowski |
| Shërbimet arsimore                                                                                                  | Dhjetor 2012    | Grupi i punës për shërbimet arsimore                                      |                                                                                               | Adam Lazowski |
| Shërbimet shëndetësore dhe veterinare                                                                               | Dhjetor 2012    | Grupet e punës për shërbimet shëndetësore dhe veterinare                  |                                                                                               | Adam Lazowski |



|                                      |                    |                                                       |                                                                |               |
|--------------------------------------|--------------------|-------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|---------------|
| Tatimet dhe sigurimet shoqërore      | Dhjetor 2012       | Grupet e punës për tatimet dhe sigurimet shoqërore    |                                                                | Adam Lazowski |
| Profesionet e rregulluara            | Dhjetor 2012       | Grupet e punës për profesionet e rregulluara          | Të gjitha institucionet që merren me profesionet e rregulluara | Adam Lazowski |
| Skemat e autorizimit dhe regjistrimi | Dhjetor 2012       | Grupi i punës për skemat e autorizimit                | Punonjësit e QKR dhe QKL                                       | Adam Lazowski |
| Lojërat e fatit                      | Nëntor 2012        | Grupi i punës për lojërat e fatit                     | Punonjësit e NJMLF                                             | Adam Lazowski |
| Shërbimet turistike                  | Dhjetor 2012       | Grupi i punës për turizmin                            | Punonjësit e MTKRS                                             | Adam Lazowski |
| Shërbimet e akomodimit dhe ushqimit  | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për shërbimet e akomodimit dhe ushqimit |                                                                |               |
| Prokurimet dhe koncesionet           | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për prokurimet dhe koncesionet          | Punonjësit e APP dhe METE                                      | Adam Lazowski |
| Shërbimet postare                    | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për shërbimet postare                   | Punonjësit e MITIK dhe AKEP                                    |               |
| Shërbimet financiare                 | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për Shërbimet financiare                |                                                                |               |
| Mbrojtja e mjedisit                  | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për mjedisin                            |                                                                |               |
| Shërbimet e agjencive të punësimit   | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për shërbimet e punësimit               |                                                                |               |
| Shërbimet për sigurinë fizike        | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për sigurinë fizike                     |                                                                |               |
| Shërbimet audiovizuale               | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për shërbimet audiovizuale              |                                                                |               |
| Shërbimet e komunikimit elektronik   | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për shërbimet e komunikimit elektronik  |                                                                |               |
| Shërbimet e telekomunikacionit       | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për shërbimet e telekomunikacionit      |                                                                |               |

|                                            |                    |                                                               |  |  |
|--------------------------------------------|--------------------|---------------------------------------------------------------|--|--|
| Shërbimet sportive                         | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për shërbimet sportive                          |  |  |
| Shërbimet e asistencës sociale             | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për shërbimet e asistencës sociale              |  |  |
| Tregtia e mallrave me përdorim të dyfishtë | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për tregtinë e mallrave me përdorim të dyfishtë |  |  |
| Shërbimet ligjore (profesionet)            | Janar-Qershor 2013 | Grupi i punës për shërbimet ligjore (profesionet)             |  |  |

SHËNIM: 1. Bazuar në kriteret e Direktivës së Shërbimeve dhe metodologjinë sipas aneksit 3 të këtij vendimi do të përgatiten një listë e kufizimeve (të ndaluara dhe të lejuara) dhe pyetësorët përkatës.

2. Në rast nevojë, për të njëjtat fusha mund të organizohen trajnime të tjera, rast pas rasti.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 18.4.2013  
Doli nga shtypi më 18.4.2013

|  |                  |
|--|------------------|
|  | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 54 lekë